



Mr. 11-112/01-0002073/21
No. 14 01 2021
Data 14 01 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
OpštinaSkenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Direkcija za Kultururu Omladinu i Sport
Department of Culture Youth and Sport

PLANI

I PUNËS I DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE SPORT PËR VITIN 2021

Në kuadër të Drejtorisë janë sektorët për: Kulturë, Rini, Sport, Arkivit dhe Bibliotekës, që në secilin prej tyre sipas planit të hartuar, zhvillohen aktivitete të ndryshme.

Sektori i Kulturës

Drejtoria, harton plane zhvillimore të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, në territorin e Skenderajt.

- Në kuadër të planit angazhohet për zbulimin dhe promovimin e talenteve të rinj, në fushën e artit dhe kulturës, të cilët do të japin shpirt zhvillimit dhe ngritjes së amatorizmit në komunën tonë.
- Mbështetja e ansamblit folklorik “Drenica” dhe teatrit të qytetit.
- Organizimi i festivalit folklorik Gjithëkombëtarë “RAPSODIA SHQIPTARE”.
- Bashkëpunimi me MKRS-në, për ndërtimin e kullave muze, në mënyrë që t’i shtohet sfondit të kullave në përgjithësi si objekte të trashëgimisë kulturore shqiptare.
- Promovimi dhe ekspozimi i artefakteve, të trashëgimisë kulturore përmes Muzeut të qytetit.

Sektori i Rinisë

- Synimet dhe objektivat e punës së sektorit për rini për vitin 2021 do të jenë :
- Fuqizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, përmes organizimit të tryezave dhe debateve. me qëllim që të rritet pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike.
 - Bashkëpunimi në mes të Komunës dhe organizatave rinore: Këshillat e nxënësve, KVRL-në, OJQ-të, Qendrën Rinore.

- Informimi- i të rinjve me politikat rinore, objektivat , qëllimet, aktivitetet rekreative sportive , për edukimin shëndetësor, edukimin jo formal ,çështjen e punësimit, informimin mbi njohjen e punës vullnetare.
- Fushata për mos braktisjen e shkollës nga të rinjtë.
- Identifikimi dhe bashkëpunimi me nxënës të dalluar dhe talente të fushave të ndryshme.
- Promovimi i jetës së shëndetshme tek të rinjtë, luftimin e dukurive negative, luftimin kundër substancave narkotike, duhanit, HIV/AIDS
- Mbështetja e projekteve të ndryshme, në mënyrë që t'i ndihmojnë të rinjve për të shprehur talentin dhe inovacionin e tyre

Sektori i Sporti

Drejtoria në baze të mundësive buxhetore do të bëjë të mundur :

- Mbështetjen e të gjitha klubeve sportive, për zhvillim normal të garave në nivele të ndryshme.
- Ndërtimi i objekteve dhe krijimi i hapësirave të mjaftueshme sportive për zhvillim të garave sportive të të gjitha sporteve (futboll, volejboll, basketboll, shah, mundje shenjëtari, shigjetari, not etj.)
- Promovimi i talentëve të rinjë përmes shkollave të futbollit.
- Organizimi i ligës komunale në futboll të vogël.

Sektori i Arkivit Historik Komunal

Objektivi i Arkivit historik komunal gjatë vitit 2021 është :

- Pranimin , evidentimi dhe klasifikimi i lëndëve arkivore sipas fondeve , viteve dhe natyrës së saj.
- Rregullimin e librave ekzistuese përcjellëse të lëndës arkivore si plotësimin e të njëjtave me dokumentacion dhe fakte të reja.
- Futja e të dhënave të lëndës arkivore në kompjuter.
- Përmbyllja e kërkesave të hulumtuesit shkencor të cilët kërkojnë dokumentacion në arkivin e qytetit. Kemi krijuar një kënd të veçantë për hulumtues për shfletimin dhe leximin e dokumentacionit.
- Gjatë vitit 2021 kemi paraparë që të punojmë në mbrojtjen, rregullimin, evidentimin dhe klasifikimin e lëndës arkivore të:
 1. Lënda Arkivore e Kuvendit Komunal Skenderaj, 1950-1999
 2. Lënda Arkivore e ish- Ndërmarrjeve Publike
 3. Këshilli Popullor i Komunës, 1945-1955
 4. Këshillave Popullor të Vendit, 1946-1952
 5. Do të bëhet rregullimi dhe klasifikimi i kësaj lëndë, dhe pasi të ndahet materiali i pavlefshëm i regjistraturave, do të vendoset në kuti arkivore për ruajtje të mëtutjeshme.

6. Do të krijohet pasqyre e fondeve dhe koleksioneve arkivore, për qasje më të lehtë në dokumente arkivore.
7. Do të krijohen kushtet elementare për ruajtje të dokumentacionit.
8. Të dhënat e lëndës arkivore do të regjistrohen në librat përkatës dhe do të vendosen në kompjuter.
9. Dokumentacioni i mbetur në depove e Arkivit në katin përdhes të Qendrës së Kulturës, do të zhvendoset në lokalet e reja të rinovuar, pasi të lirohen lokalet e reja, për punë më të lehtë dhe mbrojtje të kopjes fizike të dokumentacionit.
10. Krijimi i kushteve për pranimin i dokumentacionit nga institucionet publike, i cili i plotëson kushtet e parapara me ligj, për dorëzim në Arkiv.
 - Bashkëpunimi dhe kontaktet e rregullta me Arkivin Kombëtar të Kosovës
 - Organizimi i punën profesionale në të gjitha shërbimet e Arkivit si: Shërbimi i jashtëm, rregullimi i lëndëve arkivore dhe puna me palë.

Biblioteka komunale

Synimet dhe objektivat e punës së sektorit të bibliotekës për vitin 2021, janë:

- Evidentimi i librave të kërkuara nga lexuesit.
- Pasurimi i bibliotekës me libra të kërkuara dhe tituj të rinj.
- Fushat sensibilizuese për rëndësinë e leximit.
- Organizimi i Ditës Ndërkombëtare të Librit- 23 prill 2021.
- Aktivizimi i Sallës së Leximit.
- Njoftimi i lexuesve për pasurimin e titujve të rinj në bibliotekë.
- Organizimi i tryezave për librin dhe rëndësinë e librit.
- Fushata për mos braktisjen e leximit nëpër shkolla nga të rinjtë.
- Krijimi i ueb faqes së bibliotekës dhe digjitalizimi i librave të rrallë
- Pjesëmarrja e të rinjve në kërkimin e titujve të rinjë dhe librat e kërkuar për vitin 2021.
- Krijimin e hapësirave dhe sallave të leximit.
- Organizimi i fushatave sensibilizuese për librin dhe aktivitetet me të rinjtë dhe nxënësit e shkollave në komunën e Skenderajt.
- Shpallja e lexuesit të vitit.

Aktivitetet të cilat do të organizohen gjatë vitit 2021, nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Nr	Aktivitetet	Spektori	Afati
1.	“17 Shkurti”- Dita e Pavarësisë së Kosovës. Aktivitete përkujtimore, kulturore, sportive dhe rinore.	Kulturë, Rini e Sport	Shkurt
2.	“28 Shkurti” – Beteja e Çirezit Likoshanit. Akademi dhe aktivitete tjera. Sigurimi i hapësirave sportive për zhvillimin e garave. Pranimi i projekteve/kërkesave nga klubet për ndarje të subvencioneve	Kulturë, Rini e Sport	Shkurt
3.	Java kulturo-sportive “Jetojmë me lavdinë tuaj”. “Epopëja e UÇK-së” Mbajtja dhe monitorimi i turneve në Futboll, Shigjetari dhe Volejboll	Kulturë, Rini e Sport	1-7 Mars
4.	Avancimet kulturore “ Prof. Ajet Beqiri”. Aktivitete kulturore, sportive e rinore. Gara e nxënësve në letërsi dhe pikturë. Turneu memorial “Ilir Lushtaku” në futboll të vogël.	Kulturë, Rini e Sport	25-26 Mars
5.	28 Mars- Dita e përkujtimit të të rënëve, dëshmorëve dhe martirëve. Tubim Përkujtimor në Izbicë.	Kulturë, Rini e Sport	26,27 dhe 28 Mars
6.	Aktivitete përkujtimore kushtuar Ilaz Kodrës. Turneu memorial në futboll të vogël “Ilaz Kodra”. Aktivitet kushtuar Promovimit të trashëgimisë kulturore.	Sport	Prill
7.	Aktivitet me maturanët. Java e dhurimit të librit. Fushatë për librin. Orë letrare me poetët e Skenderajt. Pasurimi i Bibliotekës me tituj të rinj.	Rini, Biblioteka	Maj
8.	Dita e Fëmijëve Takimet e Teatrove shkollore. 18 Qershor- Dita e Çlirimit të Skenderajt. Aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe rinore. Kolonia e Artistëve. Ditët e muzeut dhe arkivit.	Kulturë, Rini e Sport	Qershor
9.	Aktivitete kushtuar “Ditës së Mërgatës”. Koncert nga Ansambli “Drenica”. Vizita Muzeut historik dhe	Kulturë, Rini e Sport	Gusht

	etnografik komunal. Vizita monumenteve historike dhe përkujtimore.		
10.	Muaji rinor. Pjesëmarrja në aktivitete teatrale jashtë Skenderajt.	Kulturë, Rini e Sport	Shtator
11.	Aktivitetet tjera rinore dhe shoqërore Shënimin e festave ndërkombëtare.	Rini	Gjatë gjithë vitit
12.	Mbështetja e Qendrës Rinore Publike.	Rini, Kulturë	Gjatë gjithë vitit
13.	Aktivitete rinore. Muaji i Rinisë	Rini	Shtator
14.	28 Nëntor- Aktivitete përkujtimore. Festivalit Folklorik "Rapsodia Shqiptare"	Kulturë e Rini	26,27 dhe 28 Nëntor
15.	Mbështetja financiare për Ansamblin "Drenica". (Mbarëvajtja e aktiviteteve kulturore)	Kulturë	Mars – Qershor
16.	Aktivitetet Kulturore (Muzeu, Arkivi dhe Teatri). Pjesëmarrja në aktivitete kulturore jashtë Skenderajt.	Kulturë	Gjatë gjithë vitit
17.	Ndarja e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për rezultatet e arritura në kulturë, rini dhe sport.	Kulturë, Rini e Sport	Dhjetor
18.	Aktivitete tjera kulturore : Promovime librash, ekspozita, etj.	Kulturë Biblioteka	Gjatë gjithë vitit
19.	Mbrëmje e fund vitit me të rinj.	Rini	Dhjetor
20.	Zgjedhja e Sportistit të Vitit 30 Dhjetor, Sulmi i parë mbi familjen Jashari Pritja e Vitit të Ri	Kulturë, Rini e Sport	Dhjetor Dhjetor Dhjetor
21.	Organizimi i debateve dhe tryezave të ndryshme me të rinjtë.	Rini	Gjatë gjithë vitit
	Mbështetja e klubeve sportive Përcjellja e aktiviteteve sportive të klubeve të regjistruara.	Sport	Gjatë gjithë vitit
23.	Monitorimi i gjendjes së objekteve të trashëgimisë kulturore. Sigurimi i të dhënave për ndërhyrjet në këto objekte.	Kulturë	Gjatë gjithë vitit

Vërejtje : Secili sektor në kuadër të DKRS-së ka të hartuar planin e detajuar të aktiviteteve vjetore, plane të cilat janë përmbledhur në këtë Plan vjetor të drejtorisë. Për shkak të natyrës së punës së DKRS-së, çdo vit ajo realizon edhe aktivitete të paparapara në Planin e punës të cilat dalin si nevojë e institucioneve lokale të Komunës së Skenderajt.

Skenderaj
07.12. 2020

Drejtori :
Abdyl Ymeri

